

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Fermeri shqiptar prodhon specatë të kuq me helme, Kroacia gropos 14.7 tonë
ADRESA	https://www.gazetatema.net/social/fermeri-shqiptar-prodhon-specat-te-kuq-me-helme-kroacia-gropos-147-tone-i585201
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	10 shtator 2026, 14:03:10 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	10 shtator 2026, 15:35:03 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	a11b3d5d6f3e1bb3fde835e87ed360f56b7e666095baac2493eea2b2ae5ba85e
TEKSTI	0deeee936f01a3e31f8d23932607480ec608a2425d6c836b5e76a9f0ee125e4f
PAMJA	f2dd52a7723584e77d43c788dbf8ae9ff770dc4681fd74226a69472c8d34f403

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	6939c22e7bd583dc2aea143c46ed764b45fe1b52bcf621b1cb370d64fd8685dd
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërin nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/6939c22e7bd583dc2aea143c46ed764b45fe1b52bcf621b1cb370d64fd8685dd>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored · dritarja 1280×1024 px

- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)

English

Built and Monetized by
[Kontakt](#)

English

1 e Gjyqtarë, para dhe politike - Avokati: P'adia në SPAK, e rrezikshme. Gjyqësori po behet pale me opozitenPlas në PLD, C'm Peka sulmon Belind Kelicin: Ky idioti po mbron RamenSara Mula në SJ fundit

Fermeri shqiptar prodhon specat të kuq me helme, Kroacia gropos 14.7 tonë

10 Shtator 2026, 17:35Sociale TEMA



 Fermeri shqiptar prodhon specat të kuq me helme, Kroacia gropos 14.7

Kroacia ka asgjësuar 147 kuintalë, ose 14 tonë e 700 kilogramë, specat të kuq me origjinë nga Fieri

Vendimi për groposjen e produktit shqiptar erdhi pas rezultateve të analizave, të cilat treguan se specat e kuq kishin ngarkesë të lartë me fungicidin proquinazid, në një nivel prej 0.050 mg/kg.

Sipas të dhënave të sistemit RASFF, prodhimi shqiptar rezultoi i ngarkuar me lëndën aktive proquinazid, ndërkohë që për këtë substancë niveli i lejuar i pranisë në specat është zero.

Proquinazidi, sipas listës së produkteve për mbrojtjen e bimëve të miratuara nga Ministria e Bujqësisë, tregtohet në Shqipëri me emrin Talendo, me vlefshmëri regjistrimi dhe tregtimi deri në fund të vitit 2028.

Burime për gazetaren Rudina Muça nga Top Channel bëjnë me dije se proquinazidi nuk është i ndaluar për t'u shitur, por përdorimi i tij në mënyrë kategorike nuk lejohet në perime. Lënda aktive proquinazid është e autorizuar për përdorim në kulturat e rrushit, për luftimin e sëmundjeve kërpudhore, veçanërisht të mykut pluhur.

Prania e kësaj substance në specat e kuq ngre dyshime të forta se fermeri shqiptar e ka përdorur një preparat të destinuar për vreshtat në kultivimin e perimeve.

Fermeri, por edhe specialistët apo agronomët që këshillojnë përdorimin e produkteve për mbrojtjen e bimëve, mund të kenë aplikuar një preparat të papërshtatshëm në kulturën e specit. Në përpjekje për të mbrojtur prodhimin dhe për të kapur në kohë tregun, përdorimi i një produkti të gabuar mund të ketë sjellë mbetje të larta të pesticidit në produktin final.

Por kjo nuk është hera e parë që specat shqiptarë përfundojnë në qendër të alarmit të autoriteteve kroate.

Pothuajse e njëjta histori është përsëritur më 7 shtator, kur një sasi tjetër specash me origjinë nga Shqipëria është asgjësuar pasi analizat zbuluan nivel të lartë të pesticidit acetamiprid.

Këtë herë, prodhimi shqiptar kishte kaluar përmes një tregtari maqedonas, i cili, pasi kishte blerë specat nga fermeri shqiptar, tentoi t'i riekportonte drejt Kroacisë. Sipas informacionit të disponueshëm, tregtari nuk ishte në dijeni të nivelit të pesticideve në produkt.

Ishin kontrollorët e ushqimit në Kroaci ata që zbuluan praninë e lartë të acetamipridit në specat. Si pasojë, autoritetet vendosën që produkti të asgjësohej menjëherë në territorin kroat.

Dy raste të tilla brenda një periudhe të shkurtër ngrenë pikëpyetje serioze për kontrollin e përdorimit të pesticideve në fermat shqiptare dhe për mënyrën se si produktet bujqësore kontrollohen përpara se të dalin në treg apo të eksportohen.

Veprime të tilla duhet të parandalohen në kohë nga strukturat përgjegjëse për kontrollin e ushqimit dhe sigurinë ushqimore. Inspektorët duhet të garantojnë që në fermat shqiptare të prodhohen produkte të sigurta dhe cilësore, në përputhje me normat e përdorimit të produkteve për mbrojtjen e bimëve, dhe jo produkte me mbetje pesticidesh që mund të përbëjnë rrezik për konsumatorët.



Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

[118 milionë euro për Durrësin - BE dhe Franca financojnë rehabilitimin e kanalizimeve dhe trajtimin e ujërave të ndotura](#)

13:15 Sociale / 2 komente

[“Afterschool”, falas nga 1 tetori! Lista, cilat janë 85 shkollat e Tiranës?](#)

10:55 Sociale / 2 komente

[Legalizimet mbyllen në 2028 / Përgjigje për legalizimet, brenda 30 ditëve. Shkrihen Kadastra dhe Agjencia e Pronave](#)

18:50 Sociale / 7 komente

[Dëmshtëpërbliet nga zjarret, duhet dokumentacion për tokën dhe të mbjellat](#)

16:50 Sociale / 1 koment

[Kurrikula Europiane dhe punësimi i sigurt rrisin me 60% interesin për KPGJT](#)

12:08 Sociale

[Gjetjet e PISA/ Nxënësit shqiptarë kuriozë dhe të angazhuar, Kumbaro në panelin ministror të PISA: Duam më shumë hapësira ku fëmijët mund të shkëlqejnë](#)

10:25 Sociale / 5 komente

[Rama për rezultatet e PISA-s: Shqipëria mori një “dëftesë të jashtëzakonshme”, rezultati më i mirë ndonjëherë](#)

08:45 Sociale / 49 komente

[Grant Performance, ministri Demo: 2.5 milionë euro për bashkitë që ofrojnë shërbime më të mira](#)

20:20 Sociale / 4 komente

[Kadastra shkon derë më derë, nis nga Palasa trajtimin e banesave pa dokumentacion pronësie](#)

18:57 Sociale / 3 komente

[Parkim nëntokësor te sheshi “Nënë Tereza” - Tenderi 21 mln euro, 170 vende e muze arkeologjik. Trafiku i automjeteve zhvendoset nën tokë](#)

14:00 Sociale / 10 komente

Më të lexuarat

24 orët e fundit

Javën e fundit

[Republika popullore e protestës](#)

15:20 Editorial / 118 komente

[“A nuk ju vjen turp?” - Rama u përgjigjet Demokratëve Eur...](#)

11:53 Politika / 101 komente

[Emri/ Ekzekutimi i shqiptarit në Itali, ja kush është 35-...](#)

14:50 Kronika / 19 komente

[U pretendua se aktivistja u arrestua pas denoncimit të sa...](#)

15:13 Politika / 74 komente

[Liderja e AfD: Gjermania duhet të kufizojë pagesat ndaj B...](#)

13:40 Bota / 41 komente

Blog Tema

[Përse do të jetë “fair” që Erion Veliaj të lirohet](#)

12:38 Blog / 12 komente

[Veliaj përballë standardit të ri të Gjykatës së Lartë: A do të zbatohet ligji njësoj për të gjithë?](#)

10:25 Blog / 20 komente

[Dinjtet nuk ka vetëm deputeti...](#)

09:42 Blog / 30 komente

Lajme ekskluzive!

Nëse doni të jeni i pari për t'u informuar mbi lajme ekskluzive, regjistrohuni më poshtë.

Numri juaj i telefonit

REGJISTROHU

Ju mund të ç'regjistroheni në çdo moment.

 Powered by Tomorrow.io

TemA është një gazetë e përditshme e palidhur politikisht e botuar në Tiranë, Shqipëri në gjuhën shqipe. E themeluar në korrik 1999, TemA është një nga gazetat ditore më të vjetra në Shqipëri dhe aktualisht shet rreth 15,000 kopje ditore në mbarë vendin.



Built and Monetized by

- [Politika](#)
- [Kronika](#)
- [Editorial](#)
- [Blog](#)
- [Bota](#)
- [Sport](#)
- [Shëndeti](#)
- [Turizëm](#)
- [Kontakt](#)
- [Sociale](#)
- [Ekonomia](#)
- [Antena](#)
- [Rajoni](#)
- [Kulturë](#)
- [Lifestyle](#)
- [Dossier](#)
- [Hi-Tech](#)

- [Përshkrimi](#)
- [Te dhënat personale](#)
- [Cookies](#)

Built and Monetized by

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.